



K.DH.SH.II.nr.1330/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Rizam Holding” Sh.P.K me seli në Mamushë – Prizren, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.341/23 të datës 03.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit, “Rizam Holding” Sh.P.K me seli në Mamushë - Prizren, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.341/23 të datës 03.08.2023, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar është REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Rizam Holding” ShPK me seli në Mamushë - Prizren, si e pa bazuar. II. Mbetet në fuqi Aktvendimi nr. 07.3/1541/2014, i datës 08.11.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, aplikim të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që të Aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.341/23 të datës 03.08.2023, sipas të cilit aktgjykim është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit ndaj vendimit të Doganës së Kosovës 07.3/1541/2014 datë 08.11.2018 sipas të cilit aktvendim është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit për rishqyrtimin e aktvendimit të Sektorit të Kontrollit Pas Importues 05.1 nr.518 datë 17.09.2014 me të cilin vendim subjekti në procedurë është obliguar në detyrime shtesë doganore në vlerë prej 15,412.43€. Të anulohet si e pa bazuar Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.341/23 të datës 03.08.2023, sipas të cilit aktgjykim është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është lënë në fuqi vendimi i Doganës së Kosovës

07.3/1541/2014 datë 08.11.2018 me të cilin aktvendim e paditura e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e aktvendimit të Sektorit të Kontrollit Pas Importues 05.1 nr.518 datë 17.09.2014 me të cilin aktvendim subjekti në procedurë është obliguar në detyrime shtesë doganore në vlerë prej 15,412.43€. dhe të kthehet lënda përsëri në rishqyrtim dhe rivendosje pranë Gjykatës së Shkallës së Parë.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjyqimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222 dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

- Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e organit të paditur nr. 07.3/1541/2014 datë 08.11.2018, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, Sh.P.K “Rizam Holding” – Prizren për rishqyrtimin e aktvendimit nr.05.1/518 i datës 17.09.2014 i lëshuar nga Sektori i Kontrollës Pas Importuese, si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 21.12.2018, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje, konstaton se kjo çështje zhvillohet në rigjykim dhe rivendosje sipas Aktvendimit K.Dh.Sh.II nr. 654/22 të datës 10.05.2023 të Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj gjykate, mbanë seancë të shqyrtimit kryesorë më dt.03.08.2023, në mungesë të përfaqësueses së autorizuar të palës paditëse, dhe në prani të përfaqësueses së autorizuar të palës së paditur, pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa e lenë në fuqi aktvendimin e organit të paditur, sipas theksimeve në arsyetim se: Nga provat shkresore të administruara në këtë konflikt administrativ, del se e paditura Dogana e Kosovës-Sektorit i Kontrollit pas Importues duke vepruar konform nenit 82 të KDA-së ka obliguar subjektin që të paguaj detyrime doganore në shumë prej 15,412.43€, për shkak që subjekti në vitin 2011 ka qenë i autorizuar për lirim nga butan gazi nga taksa e akcizës në sasi prej 2,965 ton (autorizim 09/02.02.2011), nga sasia e lejuar me autorizim subjekti përmes importit të brendshëm është furnizuar me sasinë prej 1,957.11 ton gaz. Nga analizat e bëra dhe deklaratimet e palës është konstatuar se me datën 31.12.2011 në stok ka mbet sasia prej 73,076.24 kg gaz. Sektori i Kontrollës Pas Importuese ka marrë masa ligjore për inkasimin e të hyrave shtesë dhe rregullimin e situatës, të paguaj taksën e akcizës në vlerë prej 13,286.58€ dhe diferencën e TVSH-së prej 2,125.85€. Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin

kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Kodit doganor dhe LPA, siç pretendohet në ankesë dhe as me shkelje të tjera të dispozitave të LKA dhe LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare, si në vështrim të nenit 194 të LPK-së. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar - aktvendimit të Doganës së Kosovës, nr. 07.3/1541/2014 datë 08.11.2018, të atakuar nga paditësi si në vështrim të nenit 44 të LKA.

Dhoma e Shkallës së Dytë, e miraton si të drejtë dhe ligjor, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sepse nga dëshmitë e administruara ka konstatuar drejtë gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim. Gjithashtu, kolegji vlerëson edhe pse nga aktvendimi i Dhomave të Shkallës së Dytë nr. 654/22 të datës 10.05.2023 lëndën e kanë kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje pranë kësaj gjykate me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë të lejoj propozimin e palës paditëse për nxjerrjen e provës përmes ekspertizës dhe bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe nxjerrjen e ekspertizës përkatëse të vërtetojë drejtë gjendjen faktike ashtu që të verifikojë se sasia e mallit butan-gaz e pashfrytëzuar gjatë vitit 2011 a posedon dokumentacion se kjo sasi ka hyrë përmes autorizimit nr.09/2011 për lirim nga norma e akcizës në periudhën 02.02.2011-31.12.2011, e po ashtu mbi parimin e barrës së provës, eventualisht të vërtetohet nga e paditura se malli që është objekt i ngarkesës me akcizë a është shfrytëzuar dhe përdorur për proces të prodhimit. Mirëpo edhe përkundër kësaj mundësie pala paditëse respektivisht përfaqësuesi i autorizuar i palës paditës nuk ka prezantuar në seancë edhe përkundër se është ftuar në mënyrë të rregullt dhe ftesën për seancë e ka pranuar, andaj edhe rrjedhimisht gjykata nuk ka asnjë propozim eventual nga palët ndërgjyqëse për nxjerrjen e ndonjë provë tjetër përveç atyre që janë në shkresat e lëndës. Andaj edhe pretendimi i përfaqësuesve të palës paditëse se pala paditëse me datë 25.07.2023 përkatësisht 9 ditë para mbajtjes së seancës i ka paraqitur në gjykatë një parashtrësë me të cilën ka kërkuar shtyrjen e kësaj seance, pasi në datën në të cilën ishte caktuar kjo seancë nuk kishte mundësi që përfaqësuesi i autorizuar të merrte pjesë në seancë, prandaj ka kërkuar shtyrjen e seancës mirëpo nuk është marrë parasysh nga Gjykata. Kolegji i kësaj gjykate nga shkresat e lëndës dhe nga arsyetimi i aktgjykimit shihet se ftesën për seancë të datës 03.08.2023 përfaqësuesit e palës paditëse e kanë pranuar me 24.07.2023 mirëpo nuk e kanë arsyetuar mungesën për mospjesëmarrjen për këtë seancë dhe askund në shkresat e lëndës e as në provat të cilat i ka konstatuar Dhoma e Shkallës së Dytë nuk gjendet një parashtrësë për të cilën po pretendon pala në ankesë.

Kolegji, shqyrtoi edhe pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore, si dhe theksimet e tjera në përshkrim të ankesës, dhe të njëjtën e refuzon si të pa bazuar dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse në këtë konflikt administrativ gjykata konstaton paditësi nuk ka paraqit prova të argumentuara që dëshmojnë të kundërtën për arsye se, nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi as në procedurë administrative tek e paditura, por as në këtë kontest tregtar

administrativ gjykatës nuk ka qenë në gjendje të provoj pretendimet se vërtet malli lëndor gëzon lirim nga taksat e Akcizës dhe TVSH-së. Gjykata nuk i ka pranuar si të bazuara pretendimet e paditësit për arsye se paditësi është dashur të provoj saktë me prova materiale argumentet dhe pretendimet e tij në padi, pasi që paditësi në rastin konkret bartë detyrimin e vërtetimit të pretendimeve në padi. Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave e të provuarit , nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj, rrjedhimisht në këtë kuptim gjykata vlerëson se paditësi nuk ka arritur të mbështes me prova pretendimet e tij si në padi ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 81.F paragrafi 1 të Ligjit nr.04/L-102, pasi që në bazë të kësaj dispozite “Tatimpaguesi do të bart detyrimin mbi vërtetimin e fakteve që mbështesin kërkesën e tij/saj”.

Pretendimet ankimore të paditësit, nga shkaqet ankimore të cekura si më lartë, si dhe theksimet e tjera si në arsyetim, kolegji i shqyrtoi në baza ligjore dhe i refuzon si të paqëndrueshme dhe me ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës administrative të LKA-së, apo të LPK-së, ligj i zbatueshëm, e po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë sipas çështjes në shqyrtim. Andaj gjykata duke i pasur parasysh dispozitat ligjore të aplikuara nga e paditura kur lëshon autorizimet për shfrytëzimin e procedurës së tillë përkatësisht për lirimin nga akciza gjatë importit të propan butan gazit i cili do të përdoret për procesin e prodhimit siç ka kërkuar dhe është pajisur edhe subjekti në procedurë për periudhën 2011, mirëpo jo për periudhën kontestuese të vitit 2012. Sipas nenit 1 të Ligjit nr. 03/L-220 për tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë, i cili parasheh se: “ky ligj rregullon normat e akcizës për mallrat e paraqitura në aneksin A të këtij ligji, të cilat në territorin e Republikës së Kosovës lëshohen në qarkullim të lirë. Ndërsa neni 2 përcakton lirimi nga norma e Akcizës” Gazet e naftës dhe hidrokarbure tjera gazoike nën kodin tarifor 2711 i paraqitur në Aneksin A të këtij ligji, i cili përdoret për qëllime prodhimi do të jetë i liruar nga norma e tatimit të akcizës. Lirimet nga tatimi i akcizës sipas paragrafit parë të këtij neni duhet të aprovohet paraprakisht nga Dogana për qëllime të nenit 236 të Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë i cili do të vlejë edhe për tarifatat e veçanta të mallrave të prodhuara në Kosovë”, andaj në interpretim të drejtë të dispozitës së lartcekur kuptohet se për çdo lirim për butan gaz për qëllime të prodhimit duhet të aprovohet paraprakisht nga Dogana, siç ka vepruar paditësi për vitin 2010 dhe 2011, ndërsa nuk ka aplikuar fare për periudhën kontestuese të vitit 2012, dhe si rezultat i kësaj e paditura me të drejtë, ka ngarkuar paditësin me obligime doganore për mallin për të cilin vetë paditësi nuk ka kërkuar trajtim favorizues për qëllime të prodhimit. Gjykata, vlerëson se për realizimin e kësaj të drejte për proces të prodhimit duhet paditësi të veproj siç ka vepruar më herët të aplikoj që të pajiset me autorizim të tillë për shfrytëzimin e kësaj procedure. Andaj në këtë rast gjykata ka konstatuar se nuk ka bazë ligjore për ta liruar paditësin nga taksat doganore shtesë.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim

në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesat, e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVË
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1330/23, me datë 16.04.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami